



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË – KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË - KOSOVË, KOSOVO POLJE



Nr. 326 , datë 15.09.2023

Në bazë të nenit 11 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për Aktivitete jashtëshkollore me nr. 02/2016 të datës 12.01.2016 Gjymnazi ” Hivzi Sulejmani” në Fushë - Kosovë, shpallë:

FTESË PËR OFERTË

Për realizimin e Ekskursionit të maturantëve të Gjymnazit “HIVZI SULEJMANI” në Fushë - Kosovë

- Ekskursionit do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë nga data 29.09.2023 deri me 03.10.2023,
- Kohëzgjatja e ekskursionit është 4 (katër) pansione të plota, në ditën e pestë (5) kthimi,
- Në ekskursion marrin pjesë 200 nxënës maturant,
- Në ofertë të parashihet çmimi i akomodimit në hotel i cili përfshinë fjetjen, sigurinë fizike, sigurinë shëndetsore, ushqimin cilësor e kalorik, shërbimin 24 orësh mjekësor, transportin dhe shpenzimet e tjera që paraqiten me rastin e vizitave në pika monumentale dhe vende historike.

Opratorët ekonomik apo Agjencionet turistike në ofertën e tyre duhet t’i plotësojnë këto kushte:

1. Agjencioni të ketë licencën sipas Ligjit mbi transportin me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit,
2. Autobuset të jenë komfor, me klimë dhe WFI,
3. Agjencioni të ketë kontrollimin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore dhe teknike – (Ofertës t’i bashkëngjiten dëshmitë për të gjithë autobusët që do të përdoren në ekskursion me nxënësit maturant),
4. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës (ekskursionit) dhe dëshmi të shërbimit teknik,
5. Agjencioni duhet të ketë dëshmitë (fotokopje) librezat e autobusave,
6. Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin psiko-fizik të ngasësve (shoferave) të autobusave,
7. Agjencioni duhet të siguron përkujdesje dhe shërbimin mjekësor për të gjithë nxënësit, që nga nisja, kohëzgjatja dhe mbyllja e ekskursionit, pastaj dëshminë e çertifikatës dhe kontratën e punës së mjekut të angazhuar,
8. Rezervimi i hotelit (dëshmi origjinale e vulosur) dhe në bashkëpunim me hotelin të ofrojë sigurim 24 orësh për nxënësit dhe personelin përcjellës,
9. Agjencioni duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve (licenca të jetë e vërtetuar edhe nga pronari i hotelit).

Afati i paraqitjes së ofertave me të gjitha dëshmitë dhe dokumentacionin është shtatë (7) ditë nga dita e publikimit në gazetë dhe në faqen zyrtare (Web) të Komunës së Fushë - Kosovës.

Dorëzimi i ofertave: Dërzimi i ofertave bëhet deri me datë 25.09.2023 në Gjymnazin “Hivzi Sulejmani” në Fushë-Kosovë. Hapja e ofertave bëhet më datën 25.09.2023 (e hënë) nga ora 14:00 nga Komisioni kompetent pa praninë e operatorëve ofertues. Ofertuesi i përzgjedhur do të njoftohet përmes telefonit apo mjeteve të tjera të komunikimit.

Fushë - Kosovë, më 15.09.2023

Drejtori i shkollës: Msc. Amir Pllana

